


# PROCEDURA

PER APLIKIMIN DHE VLERESIMIN  
E PROGRAMEVE TE STUDIMIT  
DHE INSTITUCIONEVE TE ARSIMIT TE LARTE



*Dhjetor 2007*



AGJENCIA PUBLIKE E  
AKREDITIMIT  
TE ARSIMIT TE LARTE



I.

## PROCEDURA

PER VLERESIMIN E PROGRAMEVE TE STUDIMIT  
DHE INSTITUCIONEVE TE ARSIMIT TE LARTE  
NE KUADER TE AKREDIMIT TE PARE DHE PERIODIK



## 1. Kërkesa dhe shqyrtimi i saj për fillimin e një Procesi Vlerësimi

### 1.a Paraqitja e kërkesës për vlerësim në nivel programesh dhe/ose institucional bëhet nga :

- ▶ një Institucion i Arsimit të Lartë (IAL)
- ▶ Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)
- ▶ Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL)

### 1.b Shqyrtimi i kërkesës

- ▶ APAAL mbledh kërkesat për vlerësim dhe akreditim nga IAL. Kërkesa (Formulari i Aplikimit për Vlerësim dhe Akreditim, shih bashkëlidhur Aneksin) së bashku me dokumentacionin përkatës shqyrtohen nga APAAL dhe i kalohen për miratim Këshillit të Akreditimit (KA).
- ▶ Kërkesa për vlerësim që bëhet nga MASH nuk shqyrtohet, sepse në përputhje me legjislacionin ekzistues, është i detyrueshëm.
- ▶ Kërkesa për vlerësim nga APAAL nuk shqyrtohet rast pas rasti, por këto miratohen nga KA në planin vjetor të vlerësimeve të APAAL. Në raste të veçanta, bazuar në argumentat përkatës, APAAL mund të kërkojë kryerjen e një vlerësimi jashtë planit vjetor të vlerësimeve.

## 2. Miratimi i kërkesës të IAL për vlerësim nga KA.

**2.a** Kërkesa me dokumentacionin përkatës shqyrtohen fillimisht nga APAAL. Nëse ajo është në përputhje me rregullat e paraqitjes së kërkesës nga IAL për vlerësim e akreditim, dhe nëse ekzistojnë mundësitë kohore dhe/ose financiare, kërkesa i kalohet për shqyrtim KA.

**2.b** Pasi kërkesa shqyrtohet, ajo **miratohet, nuk miratohet** (për mosplotësimin e kriterëve të përmendura në pikën 2.a) ose shtyhet në rastin kur vlerësimi nuk mund të kryhet në momentin që kërkohet, për arsyt e pikës 2a.

**2.c** APAAL njofton IAL për vendimin e marrë nga KA për kërkesën e paraqitur. Në rast mospranimi ose shtyrje, APAAL njofton IAL së bashku me argumentat përkatëse. Njoftimi nga APAAL bëhet brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës.

### **3. Afatet kohore të vlerësimit.**

**3.a** Përcaktimi nga APAAL i afateve kohore të vlerësimit. Një vlerësim i plotë në varësi të faktit nëse është në nivel institucional dhe/ose programesh, nga madhësia e institucionit, nuk duhet të zgjasë më pak se 3 muaj dhe më shumë se 2 vjet.

**3.b** Në çdo rast konkret, afatet kohore të vlerësimit të një njësie apo programi vendosen në bazë të kritereve të mësipërme nga APAAL.

**3.c** Shqyrtimi dhe miratimi i afateve kohore të vlerësimit nga KA.

**3.d** Njoftimi nga APAAL e titullarit të IAL për afatet kohore të vlerësimit.

### **4. Vlerësimi i Brendshëm**

Vlerësimi i Brendshëm ose Vetëvlerësimi kryhet sipas afateve kohore të përcaktuara dhe të miratuara më parë nga KA dhe bazuar në Udhëzuesin për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë (botim i APAAL).

Ky proces përbëhet nga:

**4.a** Ngritja e Grupit të Vetëvlerësimit.

- ▶ Kjo bëhet nga titullari i institucionit ku kryhet vlerësimi, si pas kritereve të përcaktuara në Udhëzuesin për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
- ▶ APAAL siguron mbarëvajtjen e procesit dhe zbatimin e rregullave të mësipërme për ngritjen, funksionimin dhe ndarjen e përgjegjësisë brenda grupit.

**4.b** Trajnimi i Grupit të Vetëvlerësimit nga stafi i APAAL.

#### **4.c** Kryerja e procesit të vetëvlerësimit.

Procesi i vetëvlerësimit kryhet sipas Udhëzuesit për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Gjatë kësaj faze Grupi i Vetëvlerësimit qëndron në kontakt të vazhdueshëm me APAAL dhe asistohet në rast kërkese nga ana e tij.

#### **4.d** Hartimi i Raportit të Vetëvlerësimit

- ▶ Grupi i Vetëvlerësimit harton Raportin e Vetëvlerësimit në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Udhëzuesin për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
- ▶ Grupi i Vetëvlerësimit dorëzon në APAAL Raportin e Vetëvlerësimit.

Në rast parregullsish gjatë Procesit të Vetëvlerësimit, APAAL vepron sipas kriterëve të përcaktuar në Udhëzues për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

## **5. Vlerësimi i Jashtëm**

Vlerësimi i Jashtëm kryhet sipas afateve kohore të përcaktuara dhe të miratuara më parë nga KA dhe bazuar në Udhëzuesin për Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë (Botim i APAAL).

Ky proces përbëhet nga:

#### **5.a** Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm nga ana e APAAL.

- ▶ Për këtë zbatohen kriteret e rekrutimit të përcaktuara në Udhëzuesin për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
- ▶ APAAL merr pjesë në këtë grup me 1-2 anëtarë sipas madhësisë së grupit.

#### **5.b** Njoftimi i njësisë nën vlerësim me përbërjen e Grupit të Vlerësuesve të Jashtëm dhe afatet kohore.

APAAL, kur e sheh të arsyeshme, merr parasysh ankesa të argumentuara që mund të ketë IAL për ndonjërin nga anëtarët e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm.

#### **5.c** Trajnimi i Grupit të Ekspertëve të Jashtëm nga stafi i APAAL dhe njohja e tij me raportin e vetëvlerësimit.

- 5.d** Hartimi nga APAAL i programit të vizitës në vend.  
APAAL njofton paraprakisht titullarin e institucionit për vizitën dhe programin që do të ndjekë Grupi i Vlerësimit të Jashtëm.
- 5.e** Takimi i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm me titullarin e IAL ku kryhet vlerësimi.
- 5.f** Kryerja e procesit të Vlerësimit të Jashtëm.
- ▶ Procesi i Vlerësimit të Jashtëm kryhet sipas Udhëzuesit për Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
  - ▶ Kohëzgjatja e këtij procesi është e miratuar që në fillim të procesit të vlerësimit nga KA.
  - ▶ Gjatë kësaj faze APAAL merr pjesë aktive përmes anëtarëve të saj në Grupin e Vlerësimit të Jashtëm.
- 5.g** Hartimi i draft-raportit të Vlerësimit të Jashtëm.  
Grupi i Vlerësimit të Jashtëm harton draft-raportin e Vlerësimit të Jashtëm në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Udhëzuesin për Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
- 5.h** Takimi i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm me Grupin e Vetëvlerësimit.
- ▶ Ky takim bëhet në IAL ku është kryer vlerësimi, ku bëhet i njohur dhe draft-raporti i Vlerësimit të Jashtëm.
  - ▶ Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, kur e shikon të arsyeshme, mund të marrë parasysh vërejtjet e Grupit të Vetëvlerësimit dhe i reflekton ato në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

## **6. Shqyrtimi i Vlerësimit nga KA.**

Në fund të çdo Procesi Vlerësimi, APAAL përgatit dokumentacionin e plotë të vlerësimit që përmban:

- ▶ Kërkesën për Vlerësim
- ▶ Miratimin e kërkesës për vlerësim nga KA
- ▶ Miratimin e fillimit të procesit dhe afateve kohore të vlerësimit nga KA
- ▶ Përbërjen e Grupit të Vetëvlerësimit
- ▶ Përbërjen e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm
- ▶ Raportin e Vlerësimit të Jashtëm
- ▶ Në rast kërkesë nga KA, vihen në dispozicion raportet e vlerësimit ose dokumentacion shtesë.



- ▶ KA merr në shqyrtim vlerësimin e kryer sipas procedurës e kompetencave të sanksionuara në statutin e KA.
- ▶ KA harton një raport me rezultatin përfundimtar të vlerësimit dhe rekomandimet përkatëse për Ministrin e Arsimit dhe Shkencës.
- ▶ APAAL i dërgon Raportin e Vlerësimit të Jashtëm dhe raportin e KA, Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për marrjen e vendimit.

## **7. Vazhdimësia e Vlerësimit (Follow-up)**

- ▶ Në rastin e marrjes së vendimit Akreditim me Kusht, APAAL harton një plan vazhdimësie për përbushjen e kërkesave brenda afatit të vendosur nga KA dhe ndjek zbatimin e tij në vazhdimësi.
- ▶ Pas kësaj periudhe kohore, në bazë të vlerësimit të kryer nga Agjencia, Këshilli merr vendimin përfundimtar.

## **8. E drejta e ankimimit**

- ▶ Institucionet e Arsimit të Lartë kanë të drejtë të ankohen pranë APAAL për përbajtjen e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Çdo ankimim duhet të shoqërohet me të dhëna e argumenta që mbështesin ankimin apo vërejtjet përkatëse. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mund të marrë parasysh vërejtjet kur ato janë të mbështetura në argumenta e prova konkrete dhe ti reflektojnë ato në raportin përfundimtar.
- ▶ IAL mund të ankohen pranë KA për procedurën e vlerësimit, duke paraqitur prova e argumenta të qarta në mbështetje të ankimimit. KA ngre Komisionin e Ankimimit posaçërisht për këtë qëllim.

## **9. Shpallja dhe botimi i rezultateve të vlerësimit.**

- ▶ APAAL bën publike rezultatet e vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit.
- ▶ Botimi i rezultateve të të gjitha Vlerësimeve të Jashtme dhe Vendimeve që pasojnë këto Vlerësime në vjetarin dhe në web-site e APAAL.



II.

## PROCEDURA

PER VLERESIMIN E NJE INSTITUCIONI TE RI  
TE ARSIMIT TE LARTE DHE/OSE PROGRAMI TE RI STUDIMI  
NE KUADER TE HAPJES SE TYRE.

Praktika (dosja) sillet në APAAL me shkresë zyrtare nga MASH ku kërkohet vlerësimi i në kuadër të hapjes së një IAL të re dhe/ose programi të ri studimi.

Fillimisht APAAL bën shqyrtimin në formë të praktikës. Gjatë këtij shqyrtimi APAAL verifikon ekzistencën apo jo të dokumentacionit të pranishëm në praktikë i plotësuar ky në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- a. Kur dokumentacioni rezulton i plotësuar nga pikëpamja formale, praktika futet në procesin e vlerësimit teknik dhe në përmbajtje. Ky proces përbëhet nga dy procedura:
  - 1- Shqyrtimi teknik i praktikës
  - 2- Shqyrtimi në përmbajtje i praktikës
- b. Kur vërehen mungesë dokumentacioni, praktika kthehet në MASH për t`u plotësuar nga aplikuesi.

## **I. Shqyrtimi teknik i praktikës**

Konsiston në : Vlerësimin teknik i të dhënave dhe e dokumentacionit në përputhje me kërkesat dhe kriteret e legjislacionit në fuqi për hapjen e IAL apo një Programi të **Ri** të Studimit (për më tej **PRS**), vlerësim ky i bërë nga specialistët e APAAL.

Në këtë shqyrtim nuk përfshihet vlerësimi në përmbajtje i programit të studimit, planeve mësimore dhe elementë të veçantë që lidhen me fushën specifike të programit të ri të studimit.

## **II. Shqyrtimi në përmbajtje i praktikës**

Objekt i shqyrtimit në përmbajtje të praktikës janë: programi/et i/e studimit, planet mësimore dhe elementë të veçantë që lidhen me fushën specifike të programit të ri të studimit.

Për vlerësimin cilësor të praktikës në përmbajtje, APAAL angazhon ekspertë të jashtëm vendas ose të huaj sipas fushave përkatëse, të cilët përzgjidhen sipas kriterëve të përcaktuara e të bëra publike. Ekspertët përzgjidhen nga KA sipas propozimit të bërë nga APAAL për çdo vlerësim individual. Vlerësimi me ekspertë të jashtëm i programit të ri të studimit kryhet në mënyrë anonime, anonimata i cili sigurohet nga APAAL.

- a. Eksperti/ekspertët i përzgjedhur, vlerëson programin e ri të studimit dhe elementë të tjerë akademik që lidhen me këtë program studimi në përmbajtje (stafi akademik, infrastruktura, labororet etj).
- b. Koha për vlerësimin e një programi të ri të studimit nga eksperti i jashtëm është jo më shumë se 10 ditë pune.
- c. Eksperti/ët harton Raportin e Vlerësimit të programit të ri të studimit sipas një formati të përgatitur nga APAAL dhe e dorëzon në letër, të firmosur në përgjegjësinë e tij/tyre.

### **III. Hartimi i Raportit përmbledhës i vlerësimit të programit të ri të studimit**

Specialistët e APAAL të ngarkuar me dosjen në fjalë hartojnë një raport përmbledhës . Ky raport përmbledh:

- a. Listën e dokumentacionit të paraqitur dhe/ose të plotësuar nga aplikuesi
- b. Raportin e vlerësimit teknik të APAAL
- c. Raportin në përmbajtje të ekspertit/ëve të jashtëm

### **IV. Shqyrtimi i Vlerësimit nga KA (vetëm për IAL publike)**

- a. Raporti përmbledhës i APAAL, i paraqitet KA në mbledhjen e radhës.
- b. Këshilli i Akreditimit kur e gjykon të nevojshëm/të arsyeshme mund të kërkojë të kryejë një vizitë në IAL propozuese ose kjo e fundit me një përfaqësi të saj ta prezantojë këtë projekt, në një nga mbledhjet e KA.
- c. Në fund të procesit KA vendos për vlerësimin përfundimtar dhe i propozon MASH për miratimin ose jo për hapjen e IAL dhe/ose programit të ri të studimit në fjalë.

### **V. Përfundimi i procesit të vlerësimit**

Kur hapja e PRS kërkohet nga një IAL publike

- a. Rekomandimet e KA, Raporti përmbledhës shoqëruar me praktikën, dërgohen në MASH.

Kur hapja e PRS kërkohet nga një IAL privat (i ri apo ekzistues)

- b. Raportin përmbledhës, rezultati përfundimtar të vlerësimit shoqëruar me praktikën, dërgohen në MASH.



# ANEKS

FORMULAR APLIKIMI PER VLERESIMIN DHE AKREDITIMIN  
E INSTITUCIONEVE DHE/OSE PROGRAMEVE  
TE STUDIMIT NE ARSIMIN E LARTE



## AGJENCIA PUBLIKE E AKREDITIMIT TE ARSIMIT TE LARTE

---

Formular Aplikimi për Vlerësimin dhe Akreditimin e  
Institucioneve dhe/ose Programeve të Studimit në Arsimin e Lartë

### **Informacion për Institucionin / Njësinë që kërkon vlerësimin**

- **Emri i Institucionit** \_\_\_\_\_

Statusi i Institucionit  Publik  Privat

Emri i njësisë që kërkon vlerësimin \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Adresa e Institucionit/njësisë \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Telefon/ Fax \_\_\_\_\_

E-mail \_\_\_\_\_

web site \_\_\_\_\_

- **Titullari i Institucionit/Njësisë**

Emër/Mbiemër \_\_\_\_\_

Telefon /Fax \_\_\_\_\_

E-mail \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

- **Personi i kontaktit në IAL që do të ndjekë vlerësimin**

Emër/Mbiemër \_\_\_\_\_

Telefon /Fax \_\_\_\_\_

E-mail \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_



## Karakteristikat e Njësia që kërkon vlerësimin

- Njësia që kërkon të vlerësimin është:

departamenti     fakulteti     universiteti     tjetër

- Lloji i vlerësimit të kërkuar

Institucional     Programi     Institucional / programi (miks)

- Emërtimi i programit/eve të studimit që kërkohet/n të vlerësohet/n

1. \_\_\_\_\_  
2. \_\_\_\_\_  
3. \_\_\_\_\_  
4. \_\_\_\_\_

- Programi i studimit që kërkohet të vlerësohet është:

Program studimi Universitar:

Cikli i I	Diplomë e Nivelit të Parë	DNP	<input type="checkbox"/>
Cikli i II	Diplomë e Nivelit të Dytë	DND	<input type="checkbox"/>
	Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë	DIND	<input type="checkbox"/>
	Master i Nivelit të Parë	MNP	<input type="checkbox"/>
Cikli i III	Program Studimi i Doktoratës	PSD	<input type="checkbox"/>
	Program Studimi Specializues Afatgjatë	PSA	<input type="checkbox"/>
	Master i Nivelit të Dytë	MND	<input type="checkbox"/>

- Format e studimit për çdo program studimi që kërkohet të vlerësohet

Studime me kohë të plotë  Studime me kohë të pjesshme  Studime në distancë

- Periudha e preferuar nga IAL për kryerjen e vlerësimit

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

- Akreditimi është

I pari që kryhet     Periodik     Tjetër

Kërkuesi

Datë, \_\_\_\_\_

## SHENIM

Së bashku me këtë formular të plotësuar, IAL duhet të paraqesë dhe Kërkesën me Shkrim të titullarit të IAL.

Në këtë kërkesë duhet të përfshihen edhe të dhëna mbi:

1. Argumentimi pse kërkohet ky vlerësim dhe akreditim
2. Strukturën organizative të IAL që kërkon të vlerësohet
3. Numri dhe Emërtimi i Diplomave që lëshohen nga IAL
4. Të dhëna për personelin akademik :  
Personel akademik efektiv                      Numri / kualifikimi  
Personel akademik me kontratë              Numri / kualifikimi
5. Të dhëna për personelin ndihmës akademik dhe administrativ të IAL
6. Numri i studentëve të IAL dhënë sipas viteve dhe programeve të studimit

Përveç kërkesës së mësipërme, duhet të bashkëngjiten edhe dokumentat e mëposhtme:

- Dokumentacioni ligjor i IAL i hapjes, licensimit apo tjetër, që kërkon të vlerësohet (fotokopje)
- Vendimet e Akreditimeve të mëparshme (nëse ka)

*Për çdo hollësi të mëtejshme mund të kontaktoni:*

### **Agjencia e Publike e Akreditimit të Arsimit e Lartë**

Adresa : Bulevardi "Zhan D`Ark" pall. e Lanës Nr. 2,

Shk. 2, ap.17 Tiranë

Tel / Fax : +355 4 2257 954 / 2266 302

E-mail : [aaal@albmail.com](mailto:aaal@albmail.com)

Website: [www.aaal.edu.al](http://www.aaal.edu.al)





AGJENCIA PUBLIKE E  
AKREDITIMIT  
TË ARSIMIT TË LARTË

Bulevardi "Zhan D'Ark", Pallatet e Lanës,  
Nr.2, Ap.17, Tiranë  
Tel/Fax: +355 4 2257 954 / +355 4 2266 302  
E-mail: [aaal@albmail.com](mailto:aaal@albmail.com)  
Website: [www.aaal.edu.al](http://www.aaal.edu.al)